



KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



NJOFTIMI PËR SHTYP

Komisioni rregullator për energjetikë dhe shërbime të ujit i republikës së maqedonisë së veriut (KER) e vlerëson si legjitime, por të pakuptimtë dhe në kundërshtim me ligjin kërkesën publike të drejtorit të NQP-së që KRE të ngrijë çmimin e CNG (metanit) dhe ta rregullojë atë, sepse bëhet fjalë për aktivitet tregtar, i cili nuk është në kompetencën e KRE-së.

Sipas Ligjit për Energjetikë, i cili është miratuar nga Komuniteti për Energjetikë, KRE nuk guxon të lëshojë licenca për tregti me CNG, duke u nisur nga fakti se tregu i gazit natyror në vend është plotësisht i liberalizuar duke filluar nga data 01.01.2015.

“Komisioni Rregullator për energjetikë vendos vetëm tarifat për bartjen dhe shpërndarjen e gazit natyror, nuk lëshon liçenca për tregtim me CNG, sepse tregu i gazit natyror ka 7 vite që është i liberalizuar. Vendim për ngrijen e çmimeve sjell Qeveria. Tha Marko Bislimoski, kryetar i KRE-së.

Gazi natyror i transportuar në enë speciale, i cili është në gjendje të ngjeshur, CNG ose shpesh i quajtur "metan" mund të tregtohet lirshëm pa liçencë. Blerjen dhe shitjen e gazit natyror të ngjeshur mund ta kryejë çdo person juridik apo fizik për nevojat e veta. Çmimi i këtij karburanti nuk është i rregulluar dhe ai formohet lirisht nga tregtarët e CNG.

5.1.2022

